

Data 27/11/2025

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Investime për infrastrukturën e tregjeve, hapësirave tregtare, multifunksionale, rrugë tregëtare në zona model zhvillimi, etj. Faza III, Rajonet 3&4: Tregu Vlorë - Faza 2”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Vlera e fondit limit: 179,339,125.54 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor IVR. Kodi i Projektit 24AF602.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë monetar dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024** të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "b", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve te njëpasnjeshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja b" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufiri të ulët dhe të lartë monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve.

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

NP 1	A	Punime gërmimi në tokë.
NP 2	B	Ndërtime civile dhe industriale.
NP 3	A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
NP 4	C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
NP 11	A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
NP 12	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PER PUNIMET SPECIALE TE NDERTIMIT

NS 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
NS 2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
NS 4	A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

NS 8 B Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
 NS 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
 NS 18 A Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zerat dhe vlerat e punimeve, si me poshte:

Kategoria e kërkuar		Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit sipas kategorisë përkatëse	Vlera e punimeve, sipas kategorisë përkatëse
NP 1	A	Punime gërmimi në tokë.	Gërmim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, në kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk në mjet Gërmim e transport dheu kat I-re me skreper, L=100m dhe V=6~6.5m³ Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në toke Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km	0-20 milion lekë	1,361,971
NP 2	B	Ndërtime civile dhe industriale.	Shtrese betoni C25/30 Shtrese me pllaka terrakote Mbulim i plote me panel policarbonat 2 cm i tejdukshëm Mbulim me derrase të stazhionuar e trajtuar me llak Shtres betoni i rrashinuar Kubik Betoni Mur me tulla të lehtësuara dopio deri 8 m, LL.P. M-15 Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa Suva brenda muri tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm Patinim tavani allçi (stuko)	21-50 milion lekë	25,583,216

			Plintuse pllake grez Veshje me pllake majolike Patinim muri me stuko Boje vaji siperfaqe metalik Boje hidroplastike Skele me tubo fasade ~ 8m Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm Hidroizolim me nje shtres astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B Shtrese lluster cemento 1:2 Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm Struktura monolite betoni C 25/30 F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm Veshje shkalle me travertine Shtres me pllaka travetine		
NP 3	A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	Veshje fasade me mermer travetin t=3cm Ulluk horizontal me profil metalik Veshje fasade me mermer travetin t=3cm Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm Veshje kornize llamarine xingat Shkalle druri	0-20 milion lekë	9,142,579
NP 4	C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Shtrese stabilizant t=15cm Shtrese zhavor lumi t=20cm, me cilindrim Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Struktura monolite betoni C 25/30 Ndertim puseta betoni 1.5x1.5 H=2 m+kapak gize F.V. Pusete betoni me kapak gize dhe gjithë aksesoret 80x80x80 Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m3 C 16/20 F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm F.V. Detaje metalike ne b/a Nenshtrese rere Shtrese zhavori F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm Shtrim me beton te lare te pigmentuar me agregate ne dukje Stola betoni Stola druri Veshje me dru strukture metalike Shtresa e gomës me ngjyrë në EPDM të ricikluar, trashësia 2 cm Shtrim me beton te lare me agregate ne dukje Kunete betoni Pusete plastike me kapak 30x30x30 ne mure Kosh mbeturina Kosh druri Stol dekorativ me beton te derdhur dhe terazo Tezgat Profil metalik per ndarje shtresash Llamarine dekorative per emertimin e dyqaneve	51-100 milion lekë	64,207,678

NP 11	A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	F.V. Pusete plastike me kapak 30x30x30cm ne mur Tub plastik dy shtresor me diameter te jashtem d=63mm Tub plastik dyshtresor me diameter d=125mm Kuadri elektrik Ndricimi K.E.N i plotësuar me te gjithë aksesoret sipas skemes dhe i gatshem per perdorim F.V. Kabllo fuqie FG16OR16, Cu, 0.6/1 kV, me izolim gome HEPR dhe mbulesë PVC jo e përhapshme ndaj zjarrit, e përshtatshme për vendosje në tokë, $S=3 \times 1.5 \text{ mm}^2$ F.V. Kabllo fuqie FG16OR16, Cu, 0.6/1 kV, me izolim gome HEPR dhe mbulesë PVC jo e përhapshme ndaj zjarrit, e përshtatshme për vendosje në tokë, $S=2 \times 2.5 \text{ mm}^2$ F.V. Kabllo fuqie FG16OR16, Cu, 0.6/1 kV, me izolim gome HEPR dhe mbulesë PVC jo e përhapshme ndaj zjarrit, e përshtatshme për vendosje në tokë, $S=4 \times 2.5 \text{ mm}^2$ F.V. Kabllo fuqie FG16OR16, Cu, 0.6/1 kV, me izolim gome HEPR dhe mbulesë PVC jo e përhapshme ndaj zjarrit, e përshtatshme për vendosje në tokë, $S=4 \times 4 \text{ mm}^2$ F.V. Kabllo fuqie FG16OR16, Cu, 0.6/1 kV, me izolim gome HEPR dhe mbulesë PVC jo e përhapshme ndaj zjarrit, e përshtatshme për vendosje në tokë, $S=4 \times 6 \text{ mm}^2$ F.V. Kabllo fuqie FG16OR16, Cu, 0.6/1 kV, me izolim gome HEPR dhe mbulesë PVC jo e përhapshme ndaj zjarrit, e përshtatshme për vendosje në tokë, $S=4 \times 10 \text{ mm}^2$ F.V. Percjelles bakri i izoluar per tokezimin e shtyllave $S=10 \text{ mm}^2$ F.V Kuader Markata K.E.M sipas projektit dhe ST, IP40, me gjithë automatet dhe paisjet e tjera mbrojtese F.V Kabell FG16OR16, 5G16mm² F.V. Pusete plastike me kapak 30x30x30cm ne mur Kanaline metalike e brimezuar Zn 100x75mm, e kompletuar me aksesore montimi (Kthesa, Kryqezime, Reduktore, Nderrim plani, kapak, aksesoresh etj sipas rastit) F.V Kuti 3 Modulare brenda murit, per celesa e priza, e kompletuar me suport 3M dhe me aksesore fiksimi ne mur. F.V Kuti 6 Modulare brenda murit, per celesa e priza, e kompletuar me suport 6M dhe me aksesore fiksimi ne mur. F.V Kuti shpërndarëse me montim jashte muri C-4 F.V Detektor levizje 360 h=2.8/8m IP40 (jashte murit) F.V Tapa mbushese 1 modul F.V Shtize rrufepritesi H-2m Ndricules rruge te larte deri ne 6 meter Ndricules te ulet per sheshe (h=1 meter) Ndricules led i vendosur ne modulet e cadrave F.V Shirit V4A 30x3.5mm I betonizuar ne pllaken e themelit. F.V Shufer V4A Ø10mm per konturin e tokezimit dhe rrufepritesit F.V Morsete V4A shirit-shufer, kryq Morsete V4A shufer-shufer D10mm V. Montim Ndriculesi tip spot F. Ndricules emergjence SmartLed me autonomi 1 ore, 650 lm > F. Spot Inkaso tip 1 F. Spot Inkaso Tip 2 F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm²	0-20 milion lekë	12,998,258
----------	---	--	---	------------------	------------

			F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2 F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm2 F.V. Çeles 1 polar 220V 10A F.V. Priza shuko universal F.V. Portollampa norm 10 A F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w, IP40 F.V. Kuti suport pllaket 4 mod F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar, L=1.5m		
NP 12	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	F.V. Fidane Peme dekorative F.V. bime dekorative te ulta F.V. Fidane bime dekorative (Cupressus sempervirens, Olea europaea)	0-20 milion lekë	1,136,122
NS 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje mur tulle me pastrim Prishje shtresa betoni	0-20 milion lekë	146,801
NS 2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	V. Montim Sensor zjarri V. Montim Paneli i kontrollit të alarmit të zjarrit me një kapacitet 16 loop F. Central Zjarri Konvencional me 1 Zone. I kompletuar me kase dhe vendosje ne mur F. Dedektor optik Tymi, i kompletuar me bazen perkatese > F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 200 F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, Pn 16 F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25 F.V. Hidrante Ø 50 mm F.V. Lavamane porcelani F.V. WC allafrenga		571,736
NS 4	A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.	F.V. Dritare druri dyfishe dopio xham kase bylme F.V. Dyer druri F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e II-te.	0-20 milion lekë	979,767
NS 8	B	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.	Ura druri. Ndertimi i strukturtes mbajttese F.V profile metalike per cadrat dhe Markaten Shtepi druri	21-50 milion lekë	49,390,671

NS 14	A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	V. Montim Ndricuesi emergjense V. Montim Kamera V. Montim Sinjalizues akustik vizual I brendeshem F.V Prize RJ45 CAT 6e 1 mod F.V Kabell FTE4OHM1, S=2x1.5mm², bashke me aksesoret e montimit, gati per pune. F.V Kabell FTP CAT 6e F.V Box-6W per Audio F. Kamera IP DOME 4MP(2.8mm) IR (30m) POE e kompletuar me aksesore, gati per pune F. Buton per thirrje manuale I adresueshem > F. Sirene e brendshme dixhitale e adresueshme Akustike dhe optike F. Rack 12U 600x600mm duke perfshire te gjithë aksesoret dhe ventilatoret e ftohjes Modem Wi-Fi Amplifikator Rack 12U i kompletuar	0-20 milion lekë	202,773
NS 18	A	Punime topogjeodezike	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik	0-20 milion lekë	-

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinjer Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinjer Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

• **Staf Mbështetës**

1 (Nje) Arkeolog i licensuar (Licensa A.1-vezhgm arkeologjik siperfaqesor, A.2-sondazh arkeologjik, A.3 - Germim arkeologjik)

Stafi i sipërcituar është staf mbështetës

Operatori ekonomik duhet të kete staf ose te kontraktuar Arkeolog qe te kete pikat e Licenses: A.1-vezhgm arkeologjik siperfaqesor, A.2-sondazh arkeologjik, A.3 - Germim arkeologjik.

Për secilin punonjës te paraqitet diploma, kontrata e punes dhe CV.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

ARGUMENTIMI I STAFIT

Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me one te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates. Kriteri per Stafin, lidhet ngushtesisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja per inxhinieret ne objekt eshte e diktuar nga pervoja dhe legjislacioni per punimet e ndertimit. Mungesa e ketij stafi pothuajse ne c;do rast rezulton ne realizim jashte afatit, jashte normave dhe me cilesi te dobet te objekteve. Numri i stafit kryesor teknik eshte percaktuar nga pikepamja e natyres teknike te kontrates me qellimin per te patur nje rezultat sa me te mire ne mbarevajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatoret ekonomike duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten. Drejtuesi i projektit eshte pergjegjes per ndertimin objektit ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune brenda kushteve te kontrates

Punimet apo veprimtarite konkrete per te cilat kerkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:

Inxhinier Ndërtimi	Punime gjërmimi në tokë. Ndërtime civile dhe industriale. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinaash civile e industriale, veshje fasada. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Punime për prishjen e ndërtimeve. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
Inxhinier Elektrik	Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike
Inxhinier Mekanik	Punime mekanike.
Inxhinier Hidroteknik	Impiante hidro-sanitare, dhe kullimi ujerash.
Inxhinier Gjeodet	Punime topogjeodezike
Inxhinier Mjedis	Punime të inxhinierisë së mjedisit.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

1(nje) punonjes te disponoje certificate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier".

Per te deshmuar permbushjen e ketij kriteri, operatoret ekonomike duhet te paraqese:

- Diplome/certificate
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë prezencen ne objekt te personelit te mesiperm dhe/ose te kerkoje ndryshimin/zevendesimin e tyre me staf me kualifikime te njejta ose me te larta, ne rast konstatimi te shkeljeve te rregullave/normave perkatese. Ne rast perseritje mund te merren masa per nderprerjen e kontrates.

Kriteri konsiderohet i permbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet te permbaje kerkesat e autoritetit._Autoriteti/enti kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi 2.3.4: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates.

Kerkesa e mesiperme mbeshet ne ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 date 09.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontrates dhe specifikat e sajë kerkojne njohuri e pergatitje te posacme per vleresime te perpikta per te zgjidhur ceshtje qe lidhen me garantimin e sigurise dhe mbrojtjen ne pune. Ne rregulloren per sigurine ne kantier miratuar me VKM nr.312/2010 eshte percaktuar se punedhenesi per mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet te ndjeke kurse formimi perkates ne fushen e sigurise e te shendetit ne vendin e punes. Cdo punedhenes zgjedh nje ose disa persona si pergjegjes per ndihme e pare ne rast emergjencash dhe per sigurine e mbrojtjen e shendetit. Rregullorja percakton kerkesat minimale te sigurise dhe te shendetit ne pune per kantieret e perkohshem ose te levizshem, si dhe masat e pergjithshme te mbikeqyrjes. Operatori/et ekonomik/e, qe gjate kryerjes se ushtrimit te veprimtarise, duhet te kete/ne kualifikimet dhe dokumentat perkatese lidhur me ndikimin ne mjedis dhe rehabilitimit te mjedisit, per raste ndotjesh sic; parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e pergjithshme per garantimin e mbrojtjes ne nje nivel te larte te mjedisit jane detyrim ligjor per cdo subjekt tregtar person fizik apo juridik per parandalimin dhe pakesimin e rreziqeve ndaj jetes e shendetit te njeriut, sigurimin dhe permiresimin e cilesise se jetes, ne dobi te brezave te sotem dhe te ardhshem, si dhe sigurimin e kushteve per zhvillimin e qendrueshem te vendit. Garantimi i ekspertizes se mbrojtjes nga cdo rrezik dhe te papritur ne pune dhe dokumentat perkatese te personave pergjegjes i sherbejne autoritetit per te krijuar bindjen dhe besueshmeri per realizimin e kontrates.

Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 22 persona** për periudhën, 3 muajore nga momenti i hapjes se ofertave e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 muajore nga momenti i hapjes se ofertave.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit._Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Ne percaktimin e numrit te punonjesve specialisti i fushes ka bere nje analize bazuar tek faktoret, si volumet dhe kategorite e punimeve, kualifikimi i punonjesve, grafiku i punimeve, zerat e punimeve dhe oret e punes dhe pagen minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjesve dhe qendrueshmeria e tyre ne pune me koheshtrirje (3 muajore nga momenti i hapjes, tregon besueshmeri per autoritetin qe, operatori do te permbush kontraten. Deshmia e kerkuar per numrin e fuqise punetore te operatorit ekonomik e nevojshme per ekzekutimin e objektit te kontrates, eshte dokument qe verteton kapacitetin teknik dhe

profesional te operatorit, persa kohe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve ne regjistrin e sigurimeve eshte nje detyrim ligjor i punedhenesit e parashikuar nga Kadi i Punes, per rrjedhoje vertetimi i leshuar nga administrata tatimore e shoqeruara me listpagesat me kete koheshtrirje eshte dokument vertetues per qendrueshmerine e te punesuarve, pervojen e tyre, dhe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Punesimi i nje numri te caktuar, pervec; besueshmerise se operatoreve ekonomik, si nje nga kerkesat themelore te kualifikimit, perpiqet te kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punes. Po ashtu eshte nje tregues i kualifikimit dhe eksperiences qe duhet te kete kjo kategori e punonjesve. Vendosja e kriterit duke perfshire dhe stafin teknik, eshte ne perputhje me volumin e punes, natyren dhe terrenin ku do te kryhen punimet. Kriteri per kualifikim eshte vendosur qe t'i sherbeje autoritetit per te njohur gjendjen e kapaciteteve te operatoreve te cilet nepermjet dokumentacionit te vertetojne se zoterojne, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshem, si dhe kapacitetet organizative, gjithcka rre funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 216, date 13.4.2023 "Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar perinformatizimin e manualit te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim" Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos (material, punetori, makineri, transport) zeri fuqi punetore ze rreth 20% te kosos.

Total ore pune = 70,459 ore (referuar oreve te punes per cdo ze pune te preventivit)

Ore/1 dite pune = 8 ore

Total Dite pune punetori = 70,459 ore/8 ore= 8,807 dite pune

Dite pune gjithsej= 18 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 22 dite/muaj= 396 dite pune

Numri i fuqise punetore = 8,807 dite / 396 dite = 22 punetore afersisht.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi ose qira ose kontrate furnizimi

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi
1	Ekskavator me Goma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 Ton	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
3	Kamion i pajisur me Vinc min 15 Ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
4	Kamioncine	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
5	Fadroma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
6	Autobot Uji	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
7	Autobetoniere	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
8	Autopompe	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
9	Gjenerator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
10	Vibrator	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
11	Betoniere min 0.5 m ³	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
12	Miniekskavator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
13	Greider	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
14	Rul Gome-Hekur	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
15	Elektrosaldatrice	Copë	1	Ne pronesi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet ne pronesi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikaten e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore.
- b) Për mjetet e siguruar me qira, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

ARGUMENTIMI MJETET

Per te percaktuar numrin e mjeteve/makinerive te nevojshme per realizimin e kontrates, jane hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit te fushes bazuar ne VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, date 26.10.2018).

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Emertimi i punimeve
1	Ekskavator me Goma	Copë	1	Punime gërmimi në tokë. Ndërtime civile dhe industriale. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Punime për prishjen e ndërtimeve. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. Ndërtime parafabrikat beton arme,
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 Ton	Copë	2	
3	Kamion i pajisur me Vinc min 15 Ton	Copë	1	
4	Kamioncine	Copë	2	
5	Fadroma	Copë	1	
6	Autobot Uji	Copë	1	
7	Autobetoniere	Copë	2	

8	Autopompe	Copë	1	struktura metalike dhe druri. Ndërtim për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N. Punime të inxhinierisë së mjedisit.
9	Gjenerator	Copë	1	
10	Vibrator	Copë	2	
11	Betoniëre min 0.5 m³	Copë	2	
12	Miniekskavator	Copë	1	
13	Greider	Copë	1	
14	Rul Gome-Hekur	Copë	1	
15	Elektrosaldatrice	Copë	1	

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

-Projekti i zbatimit, Specifikimet teknike, raportet teknik, preventivi me zerrat e punimeve, grafiku i punimeve janë hartuar nga projektues i licencuar dhe janë pjesë e pandare e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.

ARGUMENTIMI I KRITEREVE PËRZGJEDHËS PËR KUALIFIKIM

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët	65
2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shitesë	pikët	10
3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)	pikët	10
4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)	pikët	10
5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)	pikët	5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 65] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shitesë

[0 –10 pikë]

Operatori Ekonomik per te vleresuar per kete kriter duhet të provoje se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar ne eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

- Punime për shtrim me beton te lare me siperfaqe jo me pak se 5,560 m² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit

*Perlllogaritja e volumit specifik do te kryhet ne varesi ne kohezgjatjes se kontrates (data e fillimit te punimeve-data e perfundimit te punimeve) pavaresisht periudhes brenda se ciles jane realizuar keto volume specifike.

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 3 vjecar. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punime dhe volume te kryera te realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për tu vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike te kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet situacioneve perfundimtare, aktit te kolaudit sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik, dorezimit te detyrueshem te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara (leje ndertimi, projekti etj).

Volumet specifike per kontrata te cilat nuk jane kolauduar nuk do te perfshihen ne perlllogartje.

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k3} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- ***Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.***
- ***Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.***

- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$	
P_{k4}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k4}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k4}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k4}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë garancinë sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë ofertën për vlerën PSK në rubriken specifike/zerin “Siguria në kantier (Plani I Sigurisë e Kordinimit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, datë 13.04.2023)”, në preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posaçme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të vecantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrikë në masën jo më pak se 3%, përllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas përcaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast **jo më pak se 4,779,325.81 leke pa tvsh**. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Përmbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zerin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë

e Kontraktorit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit tw shtuar), e perfshire ne oferten ekonomike te detajuar, konkretisht sipas Shtojces 2 te DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 4,779,325.81leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 4,779,325.81 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 4,779,325.81 leke pa tvsh, do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet
 $V_{\max k5}$ Vlëra më e lartë e kriterit që vlerësohet
 $P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
 O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlëra e saj do të jetë më shume se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O – (pikët e Ofertës)
 M_o – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme
 N – Numri i ofertave të vlefshme
 $PR (R_{rm})$ – Rritje e mundshme
 $M_o = O_1 + O_2 + O_3 + \dots O_n / N$
 $PR = 200 \% M_o$

Vlëra e ofertave të ofruara > PR njedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK ($200\% M_o = 51,500,000 \text{ leke} < 55,000,000 \text{ leke}$) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Projekti teknik, Specifikimet teknike, raportet teknike, preventivi me zerat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe jane pjese e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent

Gjithashtu edhe nese tek specifikimet teknike AK i është referuar vetëm standarteve europiane: “EN...” Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane.